

Short Bio

Prof. Asoc. Anjeza Pasku (Krakulli) është lektore në Departamentin e Matematikës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Ajo zotëron diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND) dhe Master të Nivelit të Dytë (MND) nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në Matematikë, si dhe ka mbaruar po në këtë fakultet studimet doktorale në fushën Algjebër dhe Analizë.

Në vitin 2022 ajo ka fituar titullin Profesor i Asociuar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu ajo ka shkruar dhe është bashkëautore e disa cikle leksionesh për degët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Matematika Diskrete, Algjebra Abstrakte dhe Plotësime në Algjebër.

Prof. Asoc. Anjeza Pasku është autore dhe bashkë-autore e disa publikimeve në revista shkencore dhe konferenca rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Aktualisht Prof. Asoc. Anjeza Pasku mban postin e Dekanit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës.